



BASHKIA  
TIRANË

**R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë**  
**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE**  
**DREJTORIA E PROKURIMEVE**

[Dt. 11.08.2022]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**OPERATORIT EKONOMIK “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK**

Adresa: Tirane Rr. "Stanislav Zuber", Nd. 2, H.I9. Njesia administrative Nr. 7, 1023,  
Tirane. Zona kadastrale 8210".

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur.**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës]* **“Përditësimi i Sistemit Telefonik dhe Modernizimi i Shërbimeve të Komunikimit të Bashkisë Tiranë” me Nr. reference REF-35653-07-06-2022** për nevoja të Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini Nr. 94 datë 12 Korrik 2022.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- **Operatori ekonomik “SYNAPSE ATS” SH.P.K, NIPT L12321011H**

Vlera e ofertës pa tvsh = 13,075,000 (trembëdhjetë milion e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë.

- **Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “ADVANCED BUSINESS SOLUTIONS- ABS” sh.p.k, NIPT K21710002J**

**“ INFORMATION BUSINESS SYSTEMS –IBS” sh.p.k, NIPT J61820057C**

Vlera e ofertës pa TVSH– 11,900,000 (njëmbëdhjetë milion e nëntëqind mijë) lekë

- **Operatori ekonomik “COMMUNICATION PROGRESS” SH.P.K, NIPTK01625001C**

Vlera e ofertës pa TVSH– 12,783,500 (dymbëdhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind) lekë

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- **Operatori ekonomik “SYNAPSE ATS” SH.P.K, NIPT L12321011H**
- **Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë  
“ADVANCED BUSINESS SOLUTIONS- ABS” SH.P.K, NIPT K21710002J  
“INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” SH.P.K, NIPT J61820057C**
- **Operatori ekonomik “SYNAPSE ATS” sh.p.k, NIPT L12321011H**

*Për arsyet e mëposhtme:*

I. Autoriteti Kontraktor, në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik ka kërkuar:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, **me një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.**

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Operatori Ekonomik “Synapse ATS” sh.p.k nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm për përmbushjen e kërkesave të kriterit 2.3.1 të dokumentave standarde të tenderit.

II. Autoriteti Kontraktor, në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik ka kërkuar:

2.3.3 Operatori ekonomik Operatori ekonomik duhet të paraqesë: Autorizim Prodhuesi ose Autorizim Distributori për pajisjet e ofertuara (zërat 1,2,3 / pika 8/ Planifikimi i Buxhetit të termave të referencës). Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.

III. Autoriteti Kontraktor, në pikën 2.3.4/a të kapacitetit teknik ka kërkuar:

“....

a) Të paktën 1 (një) specialist të çertifikuar për sisteme telefonie në nivelin ACFE OmniPCX ose ekuivalente”

Operatori ekonomik për përmbushjen e këtij kriteri ka paraqitur në spe “Certifikatën SBC Certified Essentials” për punonjësin z. B.T, e cila mban datën 02.05.2020. Në certifikatën e paraqitur citohet “Certifikata është e vlefshme për Dy Vite nga data e lëshimit”.

Referuar sa më sipër, meqenëse vlefshmëria e saj ka afat deri në “2 Maj 2022”, certifikata e paraqitur rezulton të jetë e pavlefshme në datën e hapjes së procedurës (22 korrik 2022).

K.V.O gjykon se operatori ekonomik “Synapse ATS” sh.p.k, nuk përmbush kriterin 2.3.4/a të dst.

IV. Autoriteti Kontraktor, në pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik ka kërkuar:

2.3.5 Operatori ekonomik duhet që në ofertën teknike të paraqesë markën, modelin shoqëruar me katalogë ose broshura për mallrat që oferton duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e ofruar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. (Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre). Fleta ose fletët e katalogut/broshurës që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes dhe të softëare duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.

Operatori ekonomik “Synapse ATS” sh.p.k nuk ka paraqitur ofertë teknike sipas kërkesave të këtij kriteri për zërin 1 /pika 8/ Planifikimi i Buxhetit të termave të referencës, duke mos përmbushur kështu pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik.

**Sa më sipër, KVO konkludon se operatori ekonomik “Synapse ATS” sh.p.k nuk ka përmbushur kriteret 2.3.1, 2.3.3, 2.3.4/a, 2.3.5 pjesë e kapacitetit teknik të kriterëve të vecanta të kualifikimit, shtojca 7 e dst.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ( i ndryshuar), Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

- **Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë**  
“ADVANCED BUSINESS SOLUTIONS- ABS” sh.p.k, NIPT K21710002J  
“INFORMATION BUSINESS SYSTEMS-IBS” sh.p.k, NIPT J61820057C

Pwr arsyet e mwposhtme:

- I. Autoriteti Kontraktor, në Njoftimin e Shkurtuar të Kontratës, pika 5, pjesë e Dokumenteve Standarde të Tenderit për këtë procedurë objekt vlerësimi, citon:

..“ *Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave: 13,294,469 (trembëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, i përbërë nga dy vlera që u përkasin dy llogarive të ndryshme, respektivisht llogarisë për investime dhe asaj për shpenzime korrente, si më poshtë vijon:*

1. *“Përditësimi i Sistemit Telefonik dhe Modernizimi i Shërbimeve të Komunikimit të Bashkisë Tiranë” në programin buxhetor “Investim (231)”, me vlerë të fondit limit 10,831,805 (dhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë e një mijë e tetëqind e pesë) lekë pa TVSH.*

2. *“Përditësimi i Sistemit Telefonik dhe Modernizimi i Shërbimeve të Komunikimit të Bashkisë Tiranë” në programin buxhetor “Shpenzime operative (602)”, me vlerë të fondit limit 2,462,664 (dy milion e katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.*

***Shënim: Referuar rekomandimit nr. 6911 prot., datë 28.10.2020 të APP-së, vlerat e ofertës ekonomike të investimit dhe të mirëmbajtjes të ofruara nga operatorët ekonomikë nuk duhet të tejkalojnë vlerën e fondit limit të parashikuar në njoftimin e kontratës për këto zëra, pasi në të kundërt oferta do të konsiderohet si ofertë e dhënë mbi fond limit dhe si e tillë, nuk mund të kualifikohet...”***

Referuar tabelës “Lista e cmimeve” pjesë e Shtojcës 2 “LISTA E CMIMEVE TË ARTIKUJVE” e DST, paraqitur në spe nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Advanced Business Solutions-ABS” sh.p.k, dhe “Information Business Systems-IBS” sh.p.k, vlera respektive e artikullit 4 (zëri 4) **tejkalon vlerën e fondit limit të përcaktuar nga AK për këtë zë**, konkretisht:

Mirëmbajtja e sistemit është ofertuar 4,800,000 (katër milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH, vlerë kjo që e tejkalon vlerën e fondit limit përkatës prej **2,462,664 (dy milion e katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër ) lekë pa TVSH, pjesë e programit buxhetor “Shpenzime operative (602)” të AK.**

Referuar sa më sipër, BOE “Advanced Business Solutions -ABS” sh.p.k, dhe “Information Business Systems- IBS” sh.p.k, nuk i është përmbajtur kushteve të AK për këtë procedurë prokurimi duke mos respektuar ndarjen e vlerave të artikujve të Shtojcës 2 “Lista e cmimeve të artikujve” respektivisht sipas programeve buxhetore ***“Investim (231)” dhe “Shpenzime operative (602)” të AK.***

- II. Autoriteti Kontraktor, në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik ka kërkuar:

***“2.3.3 Operatori ekonomik Operatori ekonomik duhet të paraqesë: Autorizim Prodhuesi ose Autorizim Distributori për pajisjet e ofertuara (zërat 1,2,3 / pika 8/ Planifikimi i Buxhetit të termave të referencës). Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, ëbsite, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi. ...”***

Mbështetur në Akt Marrëveshjen e Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive “Advanced Business Solutions- ABS” sh.p.k, dhe “ Information Business Systems-IBS” sh.p.k, deklarohet se:

a. Shoqëria “Advanced Business Solutions –ABS” sh.p.k merr përsipër të kryejë punimet në vlerën 77.3 %, duke marrë përsipër të realizojë zërat :

1. *Përditësimi i sistemit telefonik dhe modernizimi i shërbimeve të komunikimit të Bashkisë Tiranë (faza përgatitore, furnizim, instalim, testim),*

3. *Aparat telefonie SIP (nivel i mesëm),*

4. *Mirëmbajtje e sistemit*

b. Shoqëria “Information Business Systems-IBS”sh.p.k merr përsipër të kryejë 22.7 % të punimeve, duke marrë përsipër të realizojë zërin :

2. *Aparat telefonie SIP (nivel bazik)*

Referuar sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në spe, rezulton se BOE nuk ka paraqitur Autorizim Prodhuesi ose Autorizim Distributori në emër të shoqërisë “Advanced Business Solutions- ABS” sh.p.k, e cila sipas Akt Marrëveshjes së Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive, ka marrë përsipër të realizojë zërat 1 dhe 3 /pika 8/ Planifikimi i Buxhetit të termave të referencës.

Si rrjedhojë, BOE “Advanced Business Solutions -ABS” sh.p.k, dhe “Information Business Systems- IBS” sh.p.k nuk përmbush kriterin 2.3.3 të kapacitetit teknik.

III. Autoriteti Kontraktor, në pikën 2.3.4/a të kapacitetit teknik ka kërkuar:

“... ”

a) *Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për sisteme telefonie në nivelin ACFE OmniPCX ose ekuivalente....”*

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Advanced Business Solutions -ABS” sh.p.k, dhe “Information Business Systems-IBS” për përmbushjen e pikës 2.3.4/a ka paraqitur Certifikatën “ACFE OXO Connect” të z. K.C. pjesë e stafit të Operatorit Ekonomik “Information Business Systems-IBS”sh.p.k, i cili bazuar në Akt Marrëveshjen e Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive, ka marrë përsipër të realizojë vetëm furnizimin me “*Aparat telefonie SIP (nivel bazik)*”.

Referuar argumentimit të AK për këtë kriter citohet:

*“...Kërkesa për Specialistë të certifikuar për sisteme telefonie në nivelin ACFE OmniPCX ose ekuivalente, lidhet ngushtësisht dhe drejtëpërdrejtë me qëllimin e kontratës nëpërmjet së cilës kërkohet: ...“Përditësimi dhe modernizimi i sistemit telefonik aktual të Bashkisë Tiranë modeli “Alcatel-Lucent Enterprise OmniPCX Office”, .... në të gjithë komponentët hardëare dhe softëare të tij. Specialisti i certifikuar për sisteme telefonie në nivelin ACFE OmniPCX ose ekuivalente, garantojnë Autoritetin Kontraktor se stafi teknik i Operatorit Ekonomik është i certifikuar, ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për instalimin dhe konfigurimin e sistemeve të telefonisë si dhe për realizimin me cilësi dhe në kohë të kontratës në tërësi...”*

Në vijim të argumentimit dhe duke qenë se zëri 1/ pika 8/ Planifikimi i Buxhetit të termave të referencës sipas të cilit kërkohet “Përditësimi i sistemit telefonik dhe modernizimi i shërbimeve të komunikimit të Bashkisë Tiranë (faza përgatitore, furnizim, **instalim, testim**)”, është marrë

përsipër të realizohet nga shoqëria “Advanced Business Solutions- ABS” sh.p.k, edhe stafi i certifikuar sipas kërkesave të kriterit 2.3.4/a , duhet të ishte pjesë e stafit të operatorit ekonomik që ka marrë përsipër të realizojë këtë zë.

Si rrjedhojë e sa më sipër, K.V.O gjykon se BOE “Advanced Business Solutions -ABS” sh.p.k, dhe “Information Business Systems- IBS” sh.p.k nuk përmbush kriterin 2.3.4/a të kapacitetit teknik.

IV. Autoriteti Kontraktor, në pikën 2.3.4/b të kapacitetit teknik ka kërkuar:

“ ...

b) *Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për siguri në rrjetat kompjuterike*

...”

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik, nuk ka paraqitur në spe dokumentacion për përmbushjen e këtij kriteri.

**Sa më sipër, K.V.O konkludon se bashkimi i operatorëve ekonomik “Advanced Business Solutions -ABS” sh.p.k, dhe “Information Business Systems - IBS” sh.p.k, nuk ka përmbushur kriteret 2.3.3, 2.3.4/a, dhe 2.3.4/b, pjesë e kapacitetit teknik të kriterëve të vecanta të kualifikimit, shtojca 7 si dhe Shtojcën 2 të DST.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**COMMUNICATION PROGRESS**” SHPK, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 12,783,500 (dymbëdhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind) lekë pa tvsh është identifikuar si Oferta e Suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.